

NEWSLETTER

Publikim i SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA

Shkurt 2018



Evente

- SIGAL UNIQA Group Austria 19-vjeç
- Sigurimi i shtëpisë online
- Tregu i sigurimeve në bashkebisedim me mediat

Media & Marketing

- SIGAL UNIQA me faqe zyrtare tërësisht të re
- “Vienna Salutes Tirana” në Pallatin e Kongreseve me mbështetjen e SIGAL UNIQA
- SIGAL UNIQA kompani model për studime
- Gjimnazistët ekselentë të Tiranës në zyrat e SIGAL UNIQA
- "Kupa e Pavarësisë" zhvillohet në Gjilan me mbështetjen e SIGAL UNIQA

Tregu i Sigurimeve

- Të dhënat nga AMF për muajin janar 2018, SIGAL UNIQA udhëheq tregun

Evente



SIGAL UNIQA Group Austria 19-vjeç

Më 22 shkurt SIGAL UNIQA shënoi plot 19 vite që nga dita e themelimit më 22 shkurt 1999. Me rastin e 19-vjetorit u organizua një pritje pranë ambienteve të Hotel Sky, në Tiranë, ku me atë rast, Drejtori i Përgjithshëm, shpалosi programin që do të ndiqet nga kompania përgjatë gjithë këtij viti, si viti i 20-të i SIGAL, program i cili do të kurorëzohet me një pritje të madhe më datë 20 shkurt 2018.

Po atë ditë u ndanë edhe çmimet e konkursit për idenë më të mirë për reklamën e sigurimit të shtëpisë online. Çmimin e parë e fitoi punonjësja e departamentit të pasurisë, Elvana Tanellari, dhe dy çmimet e dyta shkuan për punonjësen e departamentit të juridikut, Albana Papajani, dhe punonjësen e departamentit të marketingut, Ermela Shima.

Teksti i reklamës që fitoi çmimin e parë u realizua reklamë, e cila aktualisht po transmetohet në pothuaj të gjitha kanalet televizive në Shqipëri.

Me rastin e 19-vjetorit të themelimit të SIGAL, stafi i SIGAL UNIQA në shenjë falënderimi dhe mirënjohjeje i dhuroi Drejtorit të Përgjithshëm një koleksion me pulla të vitit 1999 dhe një shishe verë të po atij viti.

Sigurimi i shtëpisë online

Sigurimet online janë në fokusin e kompanisë SIGAL UNIQA për këtë vit, dhe promovimi i këtyre shërbimeve dhe produkteve është i rëndësishëm. Për këtë arsye u realizua edhe reklama e re për sigurimin e shtëpisë online, të cilën mund ta ndiqni në faqen e SIGAL UNIQA në facebook, në youtube, në televizione dhe në çdo kanal tjetër mediatik.

Përveç reklamave, sigurimi i shtëpisë online po promovohet çdo të dielë në televizionin Klan, nga Ardit Gjebreja, në “E diela shqiptare”, të cilën gjithashtu përveç televizionit mund ta ndiqni në faqen zyrtare të SIGAL UNIQA në facebook.

Tregu i sigurimeve në bashkebisedim me mediat

Shoqata e Siguruesve të Shqipërisë, drejtuesë dhe përfaqësuesë të kompanive se bashku me gazetarë të medias vizive dhe asaj të shkruar u mbledhën në një takim në muajin shkurt, pranë ambienteve të Hotel Premium në Golem, Durrës, ku diskutuan mbi problematikat e tregut të sigurimeve në Shqipëri.

Përse kemi kaq pak sigurime? Përse shqiptarët njohin vetëm sigurimet e makinës? Përse media shkruan vetëm për sigurimin e detyrueshëm të makinës dhe kur dalin raportet e AMF-së dhe nuk shkruajnë për sigurimin e shtëpisë, shëndetit, për dëmet që paguhen etj? Këto ishin disa nga çështjet që u trajtuan në këtë takim, i cili ishte i dyti për nga lloji, pas atij të organizuar nga SIGAL UNIQA në tetor 2015.

Drejtori i Përgjithshëm i SIGAL UNIQA, Z. Avni Ponari e vuri theksin tek roli që ka media në informimin e publikut si faktor kyç për zhvillimin e industrisë së sigurimeve.

SIGAL UNIQA me faqe zyrtare tërësisht të re

SIGAL UNIQA Group Austria tanimë është me faqe zyrtare të re.

Që prej muajit shkurt është publikuar faqja e re, në po të njëjtën adresë: www.sigal.com.al sipas standarteve të kërkuara dhe implementuara nga Uniqa Insurance Group.

Faqja është strukturuar dhe ndërtuar sipas programeve më të fundit, dhe informacionet mbi produktet dhe shërbimet e SIGAL UNIQA janë më të plota dhe të përditësuara.

Gjithashtu në faqen e re janë të inkuadruara edhe shërbimet për blerjen online të produkteve të kompanisë, ku klientët përveç informacionit që mund të marrin për produktet, disa prej produkteve si sigurimin e shtëpisë, sigurimin e makinës, shëndetit në udhëtim, etj, mund ti blejnë direkt online.

“Vienna Salutes Tirana” në Pallatin e Kongreseve me mbështetjen e SIGAL UNIQA

"Vienna Salutes Tirana", ishte koncerti madheshtor ne skenen e Wiener Konzerthaus, me artistet më të mirë shqiptarë dhe austriakë, tre muaj më parë.

SIGAL UNIQA e mbeshteti serish kete event te jashtezakonshem, i cili në muajin shkurt u zhvillua në Tiranë, në Pallatin e Kongreseve.

Artistët e mirënjohur [Inva Mula](#), [Genc Tukiçi](#), [Vikena Kamenica](#) dhuruan një performancë fantastike me 15 shkurt, në Pallatin e Kongreseve, në koncertin "Vienna Salutes Tirana", që çel siparin e vitit kulturor Austri-Shqipëri.

Që prej themelimit të saj, SIGAL UNIQA ka mbështetur dhe promovuar me dhjetëra aktivitete dhe projekte artistiko-kulturore, në kuadër edhe të promovimit të Shqipërisë dhe talenteve shqiptare.

SIGAL UNIQA kompani model për studime

Çdo vit me dhjetëra studentë zgjedhin SIGAL UNIQA-n si një kompani model për tu studiuar dhe mbi bazën e gjetjeve nga studimi mbrojnë tezat e tyre për lëndë të ndryshme, për programe të ndryshme studimi dhe për tezat e diplomës bachelor ose master.

Ndër ta, një grup studentë të Universiteti European të Tiranës, të cilët punojnë të gjithë në pozicione menaxheriale në kompani të ndryshme, prezantuan SIGAL UNIQA më 7 shkurt, në sallat e studimit të UET, si një kompani novatore që prej fillimi të saj dhe si një stratege e tregut të sigurimeve në Shqipëri.

Gjimnazistët ekselentë të Tiranës në zyrat e SIGAL UNIQA

Arlinda, Keisi, Bojdi dhe Sara ishin nder gjimnazistet qe vizituan SIGAL UNIQA ne kuader te projektit "Tomorrow's Enterpreneurs Tirana" synimi i te cilit eshte prezantimi i nxenesve me kompanite me te suksesshme dhe novatore ne Shqiperi.

Se bashku me Znj. Ornella Kullolli te Autoritetit te Mbiqyrjes Financiare, u diskutua per rendesine e edukimit financiar te brezit te ri dhe konceptet baze te sigurimeve.

Gjimnazistet vizituan gjithashtu edhe muzeun e SIGAL UNIQA, te vetmin muze te sigurimeve ne rajon, ku u njohen me nga afer me historikun e kompanise.

Te bindur se zhvillimi i nje vendi fillon nga edukimi, bejme maksimumin per te mbeshtetur iniciativa qe kane ne fokus rinine.

"Kupa e Pavarësisë" zhvillohet në Gjilan me mbështetjen e SIGAL UNIQA

Me mbështetjen e SIGAL UNIQA u zhvillua në Gjilan "Kupa e Pavarësisë", më 17 shkurt.

Në këtë turne mbarëkombëtar garuan 4 skuadra: KF "Intelektualët" nga Gjilani, KF Tirana, KF Tetova dhe KF Kosova (Prishtinë), por në fund fituese e këtij trofeu simbolik dhe shumë miqësor u shpall skuadra nga kryeqyteti KF Tirana.

SIGAL UNIQA që prej themelimit ka mbështetur sportin në tërësi, dhe skuadra në veçanti si “Sigal Prishtina”, Ekipin e Valbonës, Federatën Shqiptare të Basketbollit, dhe që prej vitit 2015 është Sponsor Zyrtar i Federatës Shqiptare të Futbollit.

Të dhënat nga AMF, SIGAL UNIQA udhëheq tregun

SIGAL UNIQA Gorup AUSTRIA është e para në tregun e sigurimeve, me rreth 30% të tregut.

Nga të dhënat e publikuara nga Autoriteti i Mbiqyrjes Financiare për muajin janar 2018, SIGAL vazhdon të udhëheqë tregun duke zotëruar përkatësisht:

58.26% të volumit të përgjithshëm të primeve për Sigurimin e Jetës;

25.99% të volumit të përgjithshëm të primeve për sigurimin e Jo-Jetës

21.71% të volumit të përgjithshëm të primeve për Sigurimet Motorike;

47.04% të volumit të përgjithshëm të primeve në Sigurimin e Pasurisë;

39.16% të volumit të përgjithshëm të primeve në Sigurimin e Shëndetit në Udhëtim për shoqëritë Jo-Jetë.

Sipas AMF, tregu rezultoi me një ulje prej 1.59% më pak se në janar 2017. Primet bruto kapën shifrën mbi 1,257 milionë lekë. Numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 88,566 me një rritje prej 6.54% krahasuar me janarin 2017.